

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: U. K. nga fshati K. e U. Komuna e Suharekës dhe Sh. E. nga fshati D. Komuna e Suharekës, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2818/2014 të datës 16.12.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa dhe të akuzuarve, me datë 21.02.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

U. K. nga i ati S. dhe e ëma Sh. e lindur E., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin K. e U. Komuna e Suharekës ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, kuzhinier, i martuar, baba i një fëmije, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së varfër ekonomike.

SH. E. i ati B. dhe e ëma B. e lindur K., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin D. Komuna e Suharekës ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, zdruckhtar, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së varfër ekonomike.

JANË FAJTOR

Me datë 07.08.2014 rreth orës 18:00, në Prizren rrugën ..., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, me marrëveshje paraprake të akuzuarit bashkërisht e përdorin forcën, ia marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit E. M., në atë mënyrë që e shfrytëzojnë momentin e volitshëm, mos prezencën e dëmtuarit dhe me mjet të përshtatshëm e hapin dritaren e objektit përmes së cilës hyjnë brenda dhe nga kasaforta marrin 70 € e 50 cent, në këtë mënyrë të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material.

Kësodore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 46, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, ia shqiptoj dënimin nën kufirin e paraparë me ligj, ashtu që e aplikoi nenin 75 par.1 nën par.1.2 e 1.3 dhe nenin 76 par.1 nën par.1.3 të KPK dhe:

G J Y K O I

Të akuzuarin U. K.

- shqiptoj **DËNIM ME KUSHT** ashtu që ia vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) vitesh, nuk kryen vepër të re penale dhe

- **DËNIM ME GJOBË** në lartësi prej 250 € (dyqind e pesëdhjetë euro) të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 13 (trembëdhjetë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Të akuzuarin Sh. E.

- shqiptoj **DËNIM ME KUSHT** ashtu që ia vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) vitesh, nuk kryen veprë të re penale dhe

- **DËNIM ME GJOBË** në lartësi prej 250 € (dyqind e pesëdhjetë euro) të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 13 (trembëdhjetë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në kuptim të nenit 150 par.1 të LESP.

I dëmtuari E. M. nga Prizreni rruga ... nr....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit obligohen të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili prej tyre veç e veç shumë prej nga 20 €, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.2818/2014 të datës 16.12.2016, kundër të akuzuarve U. K. nga fshati K. e U. Komuna e Suharekës dhe Sh. E. nga fshati D. Komuna e Suharekës, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata shpалosi dhe bëri prezantimin e gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarve. Të akuzuarit deklaruan se nuk e kundërshtojnë asnjë provë në të cilën mbështetet aktakuza, andaj edhe në mënyrë vullnetare kanë pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohen.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 07.08.2014 në orët e mbrëmjes rreth orës 18:00, në Prizren të akuzuarit në bashkëkryerje e shfrytëzojnë momentin e volitshëm mos prezencën e dëmtuarit, i vetëdijshëm për veprimet e tyre, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete, ndërmarrin veprim të kundërligjshëm ia marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit E. M., ashtu që i heqin pengesat duke i përdorur mjet të përshtatshëm për hapjen e hapësirave të mbyllura ashtu që e hapin dritaren e objektit përmes së cilës hyjnë brenda dhe nga kasaforta marrin 70 € e 50 cent, në këtë mënyrë të dëmtuarit i shkaktojnë dëm material.

Gjykata para se të hap senacën fillestare fillimisht bëri shikimin e shkresave të lëndës, bëri analizën e deponimeve të akuzuarve dhe të dëmtuarit si edhe gjatë seancës fillestare, ka ardhë në përfundim se të akuzuarit para se të kryejnë veprën penale të vjedhjes, janë pregaditur kanë zgjedhur kohën e volitshëm. Të akuzuarit kanë eliminuar pengesa dhe me mjet të fortë e hapin dritaren e objektit të dëmtuarit, hyjnë brenda dhe nga kasaforta marrin gjësende me vlerë – të holla, me ç'rast kanë shkaktuar dëme materiale të dëmtuarit. Të gjitha këto veprime të akuzuarit kanë marrë me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj nga e cila rezulton se veprimet e këtilla kanë kryer me dashje direkte, sepse kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e veta dhe kanë dëshiruar kryerjen e saj. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale juridike. Nga kjo del se në veprimet e akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga e akuzuarve për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale me të cilën ngarkohen dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza nga se të akuzuari prej fillimit të hetimeve kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat të akuzuarve i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës të cilat prova asnjëherë nuk i kanë kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarve është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e tyre formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata si rrethanë rënduese ka marrë faktin se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të kësaj natyre, me ç'rast edhe janë në vuajtje të dënimit, sepse pranë kësaj gjykate janë dënuar me vendim meritor, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se kanë pranuar fajësinë dhe kanë tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarve gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi i tyre për kryerjen e veprës penale, premtimin e tyre se në të ardhmen do të përmbahen nga veprimet e këtilla - ku shihet se prej ditës kritike e këndeje nuk kanë kryer vepra penale, janë të gjendjes së varfër ekonomike, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla, me bindje se janë proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2779/2016 të datës 21.02.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimet, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.